



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.161

26 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 185 datë 5.11.2009	Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, të ndryshuar	7185
Ligj nr.10 186 datë 5.11.2009	Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin	7186
Dekret nr.6297 datë 22.10.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	7191
Dekret nr.6298 datë 22.10.2009	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	7192
Dekret nr.6299 datë 22.10.2009	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	7192
Vendim i KM nr.1037, datë 14.10.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Krumë-Golaj	7193
Udhëzim i MF nr.43, datë 30.10.2009	Për instalimin e pajisjeve fiskale në magazinat doganore dhe tatimore të karburanteve dhe lëshimit të kuponit tatimor	7194
Udhëzim i MF nr.44, datë 17.11.2009	Për një shtesë në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”	7195
Udhëzim i MF nr.45, datë 10.11.2009	Për një ndryshim në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar	7196
Urdhër i MB nr.652/1, datë 21.10.2009	Për delegim kompetence	7197

Kërkesë e MPPTT nr.3857/1, datë 20.10.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë	7198
Kërkesë e MPPTT nr.5743/1, datë 16.10.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga dublimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë-Milot (Komuna Thumanë).....	7200

LIGJ
Nr.10 185, datë 5.11.2009

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8537, DATË 18.10.1999 “PËR
BARRËT SIGURUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8537, datë 18.10.1999 “Për barrët siguroese”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 28 shkronjat “j” e “k” shfuqizohen.

Neni 2

Pas nenit 28 shtohet neni 28/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 28/1

Certifikata për të dhënat e regjistrit

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion, të shkruar ose në formë elektronike, për të dhënat e regjistrit, sipas kriterëve e procedurave të përcaktuara në rregulloren e barrëve siguroese.

2. Certifikata për të dhënat e regjistrit është akti shkresor, i lëshuar nga kryeregjistruesi ose akti në formë elektronike, që provon të gjitha faktet e marra nga regjistri, përfshirë datën, ndryshimin, shuarjen ose nënrenditjen dhe radhën e regjistrimit.

3. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në parimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të sigurisë juridike, përcaktojnë, me udhëzim, rastet, formën e certifikatës, afatet dhe procedurat kur noterët kërkojnë informacion të shkruar për të dhënat e regjistrit.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6346, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 186, datë 5.11.2009

**PËR RREGULLIMIN E PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR NË ZONAT ME
PËRPARËSI TURIZMIN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e pronësisë mbi truallin dhe objektet e ndërtuara në zonat e stimuluar me përparësi turizmin, që janë dhënë për realizimin e veprimtarive të stimuluar, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2
Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Zonë e stimuluar” është çdo pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, të dhëna për kryerjen e veprimtarive të stimuluar.

b) “Veprimtari e stimuluar” është çdo nismë për sigurimin e përfitimeve monetare, nëpërmjet industrisë së turizmit, e kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të shfuqizuar.

c) “Person i stimuluar” është personi fizik ose juridik, i cili ka lidhur marrëveshje qiraje dhe zhvillimi me qiradhënësin për një veprimtari të stimuluar.

ç) “Marrëveshje qiraje dhe zhvillimi” është marrëveshja e lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhënësit, ku përcaktohen kushtet specifike për realizimin e veprimtarisë së stimuluar.

d) “Njësi e ndërtuar” është objekti ose tërësia e objekteve të ndërtuara nga personi i stimuluar në zonën e stimuluar, nëpërmjet marrëveshjes së qirasë dhe zhvillimit, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

dh) “Subjekt i interesuar” është personi fizik ose juridik, i cili gëzon njësinë e ndërtuar dhe që ka kryer një veprim juridik të drejtpërdrejtë ose të rrjedhur me personin e stimuluar për kalimin e të drejtave reale mbi njësinë e ndërtuar, të ngritur brenda zonës së stimuluar, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

e) “Qiradhënësi” është autoriteti, i cili ka lidhur marrëveshjet e qirasë dhe të zhvillimit me personin e stimuluar.

ë) “Truall” është e gjithë sipërfaqja e tokës së zonës së stimuluar, brenda së cilës është ngritur njësi apo njësitë e ndërtuara, sipas marrëveshjes së qirasë dhe zhvillimit.

f) “Fshirje regjistrimi” është shënimi në kolonën përkatëse të regjistrit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në vendimin e Kryeregjistruesit, pas verifikimit të të dhënave mbi gjendjen juridike të njësisë së ndërtuar dhe truallit.

g) “Ministër përgjegjës” është ministri, në varësinë e të cilit është ALUIZNI.

2. Institucioni përgjegjës për kryerjen e procedurave për kalimin e pronësisë subjekteve të interesuara, mbi njësitë e ndërtuara dhe truallin brenda zonës së stimuluar, është Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, më poshtë ALUIZNI, e krijuar me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për kalimin e së drejtës së pronësisë subjekteve të interesuara apo personave të stimuluar mbi njësitë e ndërtuara dhe truallin brenda zonës së stimuluar.

KREU II

PROCEDURA E KALIMIT TË PRONËSISË

Neni 4

Dokumentet që duhet të paraqesë subjekti i interesuar

1. Subjekti i interesuar, që gëzon njësinë e ndërtuar, duhet të paraqesë pranë ALUIZNI-it, brenda 60 ditëve pas njoftimit publik, dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesën për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, të plotësuar sipas formularit tip të miratuar nga ministri përgjegjës;

b) kontratën e lidhur me personin e stimuluar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar;

c) planimetrinë dhe sipërfaqen në m² të njësisë së ndërtuar;

ç) dokumentet e pronësisë për njësinë e ndërtuar, nëse ka;

d) kopje të dokumentit të identifikimit ose ekstrakt të regjistrit tregtar.

2. Në rast se njësia apo njësitë e ndërtuara gëzohen nga dy ose më shumë subjekte të interesuara, atëherë kërkesa paraqitet për kalimin e së drejtës së bashkëpronësisë në tërësi mbi truallin.

Neni 5

Dokumentet që duhet të paraqesë personi i stimuluar

1. Personi i stimuluar që gëzon njësinë e ndërtuar brenda zonës së stimuluar, duhet të paraqesë pranë ALUIZNI-it, brenda 60 ditëve pas njoftimit publik, dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesën për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, sipas formularit tip të miratuar nga ministri përgjegjës;

b) marrëveshjen e qirasë apo të zhvillimit të lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhënësit;

c) lejen e ndërtimit për njësinë e ndërtuar;

ç) planimetrinë dhe sipërfaqen në m² të njësisë së ndërtuar;

d) dokumentet e pronësisë për njësinë e ndërtuar, nëse ka;

dh) kopje të dokumentit të identifikimit ose ekstrakt të regjistrit tregtar.

2. Në rast se njësia apo njësitë e ndërtuara gëzohen nga dy ose më shumë persona të stimuluar, atëherë kërkesa paraqitet për kalimin e së drejtës së bashkëpronësisë në tërësi mbi truallin.

Neni 6
Njoftimi publik

1. Për sigurimin e dokumentacionit të përcaktuar në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, ALUIZNI, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njofton në mënyrë publike subjektet e interesuara dhe personat e stimuluar.

2. Rregulla më të hollësishme për afatin, përmbajtjen dhe mënyrën e njoftimit publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
Verifikimi i të dhënave

1. Me depozitimin e dokumentacionit të përcaktuar në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, ALUIZNI bën hedhjen e të dhënave, sipas formularit të përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës.

2. ALUIZNI bashkërendon punën me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për verifikimin e gjendjes juridike dhe në terren të njësive të ndërtuara dhe me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për të evidentuar nëse ka kërkesa të depozituara nga subjekte, të cilat pretendojnë të drejtën e pronësisë mbi zonën e stimuluar.

3. ALUIZNI, në përfundim të verifikimeve të kryera me institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, harton një relacion shpjegues mbi procesin e verifikimit të kryer dhe një plan rilevimi, duke pasqyruar të dhënat urbanistike të zonës së stimuluar.

4. Rregullat e hollësishme për bashkërendimin e punës, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8
Fshirja e regjistrimit të veprimit juridik

1. Relacioni shpjegues, i hartuar sipas nenit 7 të këtij ligji, i njoftohet menjëherë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që verifikon nëse njësia e ndërtuar është e regjistruar. Në këtë rast, me paraqitjen e relacionit, regjistruesi bën pezullimin e regjistrimit dhe mbi pasurinë nuk mund të kryhen veprime, deri në përfundimin e procesit, sipas këtij ligji.

2. Në përfundim të procesit, Kryeregjistruesi vendos fshirjen e regjistrimit të veprimit juridik për kalimin e të drejtave reale mbi njësinë e ndërtuar, me qëllim regjistrimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë, sipas këtij ligji.

Neni 9
Pronësia dhe bashkëpronësia në tërësi mbi truallin

1. Subjekti i interesuar ose personi i stimuluar ka të drejtë të kërkojë blerjen e truallit të njësisë së ndërtuar, të cilën provon se e gëzon mbi bazën e dokumenteve të paraqitura në përputhje me nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

2. Nëse njësia e ndërtuar gëzohet nga dy ose më shumë subjekte të interesuara apo persona të stimuluar, ata kanë të drejtë të kërkojnë blerjen e truallit në bashkëpronësi të detyrueshme në tërësi, në raport me sipërfaqjen e njësisë së ndërtuar, të cilën provojnë se e gëzojnë mbi bazën e dokumenteve të paraqitura në përputhje me nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

3. Trualli i fituar në bashkëpronësi, sipas këtij ligji, nga dy ose më shumë persona nuk lejohet të ndahet.

4. Çdo veprim juridik, që kryhet me qëllim shkeljen e ndalimit të mësipërm, është absolutisht i pavlefshëm.

Neni 10
Kontrata e shitjes së truallit

1. Çmimi i truallit të njësisë së ndërtuar brenda zonës së stimuluar përcaktohet në bazë të hartës së vlerës së tokës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Në rastet e kalimit të së drejtës së bashkëpronësisë së detyrueshme në tërësi, ALUIZNI përcakton pjesën takuese të çmimit pas përlllogaritjes së pjesës së truallit, në raport me sipërfaqen e njësisë së ndërtuar, që gëzon secili nga subjektet e interesuara apo personat e stimuluar.

3. Ministri përgjegjës ngarkon ALUIZIN-in të lidhë kontratën e shitjes për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, sipas modelit tip, si dhe të njoftojë me shkrim subjektin e interesuar ose personin e stimuluar që plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe për masën e çmimit. Modeli tip i kontratës së shitjes miratohet nga ministri përgjegjës.

4. Kontrata e shitjes lidhet pasi të bëhet pagesa e plotë apo e pjesës takuese të çmimit të truallit të njësisë së ndërtuar. Rregulla më të hollësishme për mënyrën dhe llogaritjen e afateve të pagimit të çmimit të truallit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kontrata e lidhur sipas këtij ligji regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi Kryeregjistruesi ka vendosur, nëse është rasti, sipas nenit 8 të këtij ligji.

6. Kontrata e shitjes regjistrohet, pavarësisht nëse janë lidhur ose jo kontratat e personave të tjerë që kanë të drejta bashkëpronësie mbi truallin. Të drejtat e pronësisë mbi truallin përcaktohen në bazë të këtij ligji dhe të kontratës.

7. Kalimi i së drejtës së pronësisë apo i së drejtës së bashkëpronësisë së truallit, sipas kësaj procedure, nuk tatohet, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

Neni 11
Procedura e kalimit të së drejtës së pronësisë të njësisë së ndërtuar

1. Pas fitimit të pronësisë mbi truallin, subjekti i interesuar ka të drejtë të regjistrojë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kontratën për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar, të lidhur me personin e stimuluar.

2. Këtë të drejtë e ka edhe personi i stimuluar për njësinë e ndërtuar që gëzon, sipas marrëveshjes së qirasë dhe të zhvillimit, të lidhur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse ai nuk ka kryer veprime juridike për kalimin e të drejtave reale me subjekte të interesuara. Në këtë rast, kalimi i së drejtës së pronësisë nuk tatohet, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

3. Në rastin e njësive të ndërtuara, të paregjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI përfundon procesin e regjistrimit fillestar të tyre. Për këtë qëllim, ALUIZNI:

- a) ndjek procedurat e legjislacionit në fuqi për urbanistikën dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, kur për njësinë e ndërtuar është dhënë leja e ndërtimit;
- b) zbaton procedurat e legjislacionit në fuqi për legalizimin e ndërtimeve informale.

Neni 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për të drejtën e pronësisë

1. Kur për të njëjtën pronë kanë pretendime dy ose më shumë persona, ALUIZNI lidh kontratën e kalimit të truallit në pronësi me personin që paraqet kontratën më të hershme për kryerjen e veprimit juridik për kalimin e të drejtave reale, sipas formës së kërkuar nga ligji.

2. Mosmarrëveshjet mbi të drejtat reale në këtë rast zgjidhen nga gjykata kompetente.

Neni 13
Tarifat e shërbimit, të ofruara nga ALUIZNI

Tarifat e shërbimit, të ofruara nga ALUIZNI, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës.

KREU III
PROCEDURA E PËRLLLOGARITJES SË ÇMIMIT TË TRUALLIT

Neni 14
Mënyra e pagesës së çmimit të truallit

1. Çmimi i truallit reduktohet në masën 10 për qind, nëse paguhet brenda 3 muajve nga njoftimi me shkrim, sipas pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

2. Çmimi i truallit reduktohet në masën 20 për qind, nëse paguhet brenda 1 muaji nga njoftimi me shkrim, sipas pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

3. Të ardhurat e realizuara nga zbatimi i këtij ligji, me përjashtim të tarifave dhe tatimeve, i transferohen Buxhetit të Shtetit për të kaluar në fondin e kompensimit financiar të parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Pas këtij transferimi, Këshilli i Ministrave, në nxjerrjen e vendimit vjetor për rregullat dhe kriteret për trajtimin e vendimeve të kompensimit financiar, bazohet edhe në parimin e kompensimit financiar më të parë të subjekteve të shpronësuara, të prekura nga zbatimi i këtij ligji.

5. Çmimi i truallit që i shitet subjektit të interesuar ose personit të stimuluar është në raport me sipërfaqen e truallit, në funksion të njësisë së ndërtuar që ai gëzon.

6. Kur trualli i shitet subjektit të interesuar, çmimi paguhet prej tij në masën 80 për qind të vlerës së truallit, ndërsa 20 për qind e kësaj vlere paguhet nga personi i stimuluar.

Neni 15
Mbledhja e tatimeve të prapambetura

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe organet e qeverisjes vendore përlllogarisin dhe mbledhin të gjitha tatimet e prapambetura, nëse ka, nga personi i stimuluar, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Personi i stimuluar, për të gjitha njësitë e ndërtuara, të shitura përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas kontratës së lidhur me personin blerës, i nënshtrohet shkallës tatimore për tatimet e papaguara, sipas legjislacionit në fuqi, në datën kur është realizuar kontrata e shitjes.

3. Rregullat për afatet dhe mënyrën e mbledhjes së tatimeve të prapambetura përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16
Sanksionet

1. Kur subjekti i interesuar ose personi i stimuluar nuk paraqet kërkesë për kalimin e truallit në pronësi dhe dokumentet, sipas neneve 4 dhe 5 të këtij ligji, trualli konsiderohet i lirë dhe kalon për llogari të kompensimit fizik të ish-pronarëve, sipas ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

2. Mospagimi i çmimit nga subjekti i interesuar ose personi i stimuluar brenda 6 muajve nga njoftimi me shkrim, sipas pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji, sjell të njëjtat pasoja si në pikën 1 të këtij neni.

Neni 17
Parimet e nxjerrjes së akteve nënligjore

Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji nxirren duke respektuar parimet e kompensimit të drejtë, të barazisë para ligjit, sigurisë juridike, si dhe të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Neni 18
Shfuqizime

Paragrafi 1/ç i pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6347, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

DEKRET
Nr.6297, datë 22.10.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Murat Celal Kiyan
2. Latif Kamil Değirmenci
2. Camille Constance Bruno Benoit Bernard (Myftaraj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6298, datë 22.10.2009

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 14 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Marelsa Hajdër Nika (Bejleri)
2. Miranda Maj Nika (Stopani)
3. Benilda Petrit Vesho
4. Diana Mark Hajdaraj (Gegaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6299, datë 22.10.2009

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Merita Mitat Kupe (Vejseli)
2. Shkëlqim Ismail Aga
3. Blerina Lefi Anastasi
4. Violeta Izet Demetja (Fejziaj)
5. Artan Siri Hanaj
6. Nevila Syrja Çaraj (Caraj)
7. Eirys Albert Turraku
8. Jeniffer Albert Turraku
9. Etleva Demir Beshko (Ibrahimi)
10. Sarah Beshko
11. Paola Gëzim Beshko
12. Mirjeta Agron Koka-Schunk (Koka)

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1037, datë 14.10.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KRUMË-GOLAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Krumë-Golaj.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 133 (njëqind e tridhjetë e tre) m², tokë/truall, dhe objekt, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 680 766 (dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 347 000 (treqind e dyzet e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 680 766 (dy milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2009 dhe të përfundojë më 30.12.2009.
 7. Pronari i përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrin e pasurisë në pronësi të pronarit që shpronësohet.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
RRETHI HAS
KOMUNA GOLAJ
FSHATI LETAJ

LISTA EMËRORE E PRONARIT QË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “KRUMË-GOLAJ”

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas.	Truall			Objekt	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Vlera lekë		
1.	Petrit	Bajram	Cuni	2431	1	133	1370	182210	2498556	2680766	Konfirmuar nga ZRPP
						133		182210	2498556	2680766	

UDHËZIM
Nr.43, datë 30.10.2009

**PËR INSTALIMIN E PAJISJEVE FISKALE NË MAGAZINAT DOGANORE DHE
TATIMORE TË KARBURANTEVE DHE LËSHIMIT TË KUPONIT TATIMOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, nenit 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shitja e sasive të karburanteve (të specifikuara sipas llojeve) nga magazinat doganore të subjekteve importuese (pasi këto kanë kryer procedurat e zhdoganimit), kryhet në çdo rast nëpërmjet lëshimit të faturës tatimore, e cila shoqëron sasinë e karburantit të shitur.

2. Sasia e karburantit të dalë evidentohet nëpërmjet matësve të sasisë së dalë, të cilat janë të certifikuara nga Drejtoria e Kalibrimit dhe e Peshëmatjes dhe që kontrollohen në vazhdimësi për funksionimin normal të tyre.

3. Në momentin e daljes nga magazina doganore, sasia e karburantit të shitur, përveç faturës tatimore, shoqërohet detyrimisht edhe me kupon tatimor, i cili lëshohet nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale. Ky kupon i bashkëngjitet faturës tatimore për çdo dalje të karburantit (shitje të tij) dhe e shoqëron faturën tatimore gjatë gjithë lëvizjes (transportit) nga pika e daljes nga magazina doganore, deri në vendin e shkarkimit të karburantit në depozitat e subjektit blerës. Ai mbahet i tillë i bashkëngjitur me faturën tatimore nga blerësi.

4. Kuponi tatimor, i cili do t’i bashkëngjitet faturës tatimore të shitjes, duhet të përmbajë detyrimisht të regjistruara të gjitha të dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të dhëna të cilat do t’u jepen për formatim subjekteve të autorizuar nga Ministri i Financave për furnizimin me pajisje fiskale. Këto pajisje instalohen e mirëmbahen vetëm nga këto shoqëritë të autorizuar.

5. Subjektet e shitjes së karburantit nga magazina doganore janë të detyruara të raportojnë periodikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me udhëzimin nr.39, datë 9.12.2008 të Ministrit të Financave, njëloj sikurse subjektet e tjera përdoruese të pajisjeve fiskale.

6. Subjektet transportuese të karburantit pas daljes nga magazina doganore, qofshin këto thjesht subjekte transportuese, në pronësi të subjektit blerës apo shitës, detyrohen të mbajnë të bashkëngjitur me faturën tatimore edhe kuponin tatimor që i përket blerjes së karburantit që po transportohet. Mosparaqitja e këtij të fundit së bashku me faturën në momentin e një kontrolli të mundshëm, i penalizon ato sikurse moslëshimi i faturës, bazuar në nenin 21 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. I njëjti penalitet zbatohet edhe për subjektin transportues, kur ky është subjekt vetëtransportues (i ndryshëm nga shitësi).

7. Kuponi tatimor (pjesë shoqëruese e faturës tatimore) përmban të gjitha elementet e përcaktuara për lëshimin e tij, sidomos sasinë e shitur (të dalë nga magazina doganore), çmimin për njësi pa TVSH, vlerën e TVSH dhe vlerën me TVSH.

8. Kuponi tatimor kontrollohet nga doganieri në pikën e daljes nga magazina doganore. Ky i fundit nuk lejon lëvizjen e karburantit nga magazina doganore (qoftë me mjete transporti, qoftë nëpërmjet lidhjes me tubacion) pa u lëshuar (prerë) kuponin tatimor, krahas lëshimit të faturës tatimore. Çdo lëvizje e karburantit pa lëshimin e kuponit tatimor krahas faturës tatimore, ngarkon me përgjegjësi ligjore dhe penalitete tatimore subjektin shitës, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi administrative, sipas kuadrit ligjor në fuqi punonjësën e doganës në vendin e daljes së karburantit nga magazina doganore, nëse ai nuk kontrollon lëshimin e kuponit.

9. Procedurat e pajisjes me dokumentacionin e përcaktuar më lart, për rastet e daljeve nga magazinat doganore, detyrohen të zbatohen edhe nga shoqëria “ARMO” sh.a. për daljet e karburanteve nga magazina tatimore.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet strukturave të tyre, kryejnë kontrole të vazhdueshme e të përbashkëta, për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi. Për zbatimin me korrektësi të këtij udhëzimi, ato vënë në dijeni subjektet që disponojnë magazina doganore për karburantin, dhe subjektin sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, si dhe udhëzojnë punonjësit që ngarkohen me kontrollin e zbatimit të detyrave që dalin nga ky udhëzim.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.44, datë 17.11.2009

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHITUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 35 e 58 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, pas pikës 20.2 “*Rimbursimi për marrëveshjet financiare*”, shtohet pika 20.3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“**20.3.**Në rastin e zbatimit të Marrëveshjeve kuadër “Mbi bashkëpunim dhe zhvillim”, midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, financimet në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë të përjashtuara nga TVSH-ja. TVSH-ja do të financohet nga përfituesi vendas në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe faturohet e paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e furnizimeve për zbatimin e projektit. Skema e aplikimit të TVSH-së do të bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit

të Ministrave nr.509, datë 12.8.1996 “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë. Përjashtimi nga TVSH-ja për entet zbatuese të marrëveshjes kuadër të bashkëpunimit dhe zhvillimit, bëhet vetëm në rastet e përjashtimeve të parashikuara në nenet 20-26/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.45, datë 10.11.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 2.12 e udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

2.12. Importuesit e “Maltos”, “Letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër” (kjo e fundit me kodin e NC 48 13 10 000 000), që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize, subjekte të prodhimit të birrës dhe cigareve, duhet të bëjnë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë autorizimin për importimin e maltos dhe letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, për qëllime tregtie. Autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jepet për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë përsëritje. Çdo subjekt që do të bëjë kërkesë për autorizim si importues i maltos dhe letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, për qëllime tregtie, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë më shumë se 3 vjet i regjistruar në organet tatimore si person i tatueshëm i TVSH-së.

b) Të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vet ekonomike.

c) Të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo autorizim të lëshuar për tatimpaguesit si importues të maltos, letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zhdoganimi i “letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër” të bëhet me copë.

Importuesi i Autorizuar, për çdo rast të importimit të maltos, letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtrin, duhet të depozitojë si garanci përpara zhdoganimit, në një llogari bankare, 120 lekë për kg malto të importuar dhe 50 lekë për 20 copë “letër cigare në formë tubi, bashkë me filtrin” garanci (zhdoganimi për letrën e cigares në formë tubi, bashkë me filtër, do të bëhet në copë), e cila do t’i kthehet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të shitjes së maltos dhe letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, tek tatimpaguesit e autorizuar si prodhues birre dhe prodhues cigare.

Në rastet kur një tregtari të autorizuar për importimin e maltos ose letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, i gjenden sasi të maltos, letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër të padokumentuara ose vërtetohen shitje te persona të paautorizuar si prodhues birre, prodhues cigare, ndaj tij aplikohen sanksionet e parashikuara në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe i hiqet e drejta e ushtrimit të këtij aktiviteti duke i tërhequr autorizimin si

importues malto, letre cigare në formë tubi, bashkë me filtër, për një periudhë 2 vjeçare. Organi tatimor ka të drejtë të mbajë garancinë e depozituar për kompensimin e dëmit ekonomik. Nëse personi nuk ka garanci ose ajo nuk është e mjaftueshme për përballimin e dëmit ekonomik, tatimpaguesi paguan shumën totale ose pjesën që nuk mbulohet nga garancia, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit nga organi tatimor. Në të kundërt organi tatimor zbaton procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.652/1, datë 21.10.2009

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për miratimin e urdhër/programeve për “pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 15.5.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Integritit për hartimin, zbatimin e procedurave mbi programet për pritjen, përcjelljet dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

KËRKESË
Nr.3857/1, datë 20.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm...për interes publik”, si dhe në bazë të akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ky publikim bëhet për pasuritë: truall dhe objekte. Vlerësimi i pasurisë truall është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007, ndërsa objektet janë vlerësuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 29 614 986.25 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KALIMASH-MORINË“

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas	Truall			Objekte Vlera Lekë	Totali Lekë	Vendndodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m²	Çmimi m²	Vlera lekë				
1	Abedin	Rasim	Oruçi	1543	157/2 157/3	292	2023	590716	25757107	26347823	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
2	Habibe	Ahmet	Oruçi	1543	157/4	115	2023	232645		232645	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkim	Selman	Cenaj	2315	41/28				306238	306238	Qytet Kukës	Konfirmuar nga ZRPP
4	Vesel	Adem	Dida	1176	297/4				2728280.25	2728280.25	Breg-Lum	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				407		823361	28791625.25	29614986.25		Konfirmuar nga ZRPP

KËRKESË
Nr.5743/1, datë 16.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga dublimi i segmentit rrugor Fushë-Krujë-Milot (Komuna Thumanë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit tokë: arë dhe truall.

Për të gjithë pronarët është bërë shënimi “Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi”, për arsye se për këto pasuri të publikuara që u përkasin fshatrave Bushnesh dhe Thumanë janë në proces saktësimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë.

Kjo do të thotë që pas kryerjes së saktësimeve të nevojshme nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, do të rimerret konfirmim lidhur me titullin e pronësisë së pronarëve të publikuar dhe të pronarëve të papublikuar (për arsye të mungesës së numrave respektive të pasurive), por që preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor. Në bazë të konfirmimit që do të jepet nga ZRPP Krujë, do të kryhen verifikime nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, lidhur me pasuritë dhe sipërfaqet përkatëse. Si rezultat i këtyre veprimeve të nevojshme ligjore mund të ketë ndryshime të sipërfaqeve të publikuara (në rritje apo në zbritje), kjo në varësi të të dhënave që do të jenë pasqyruar në hartat treguese të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë, si dhe në varësi të verifikimeve faktike.

Janë të lutur të gjithë pronarët, pasuritë në pronësi të të cilëve nuk figurojnë në këto lista, por që preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor, të paraqiten pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë për të aplikuar për regjistrimin e pasurive të prekura, në të kundërt do të jetë e pamundur ligjërisht kompensimi i tyre për efekt shpronësimi.

Janë të lutur gjithashtu dhe pronarët, të cilët figurojnë në listat e publikuara të paraqiten pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë për të kryer veprimet e nevojshme për saktësimin e pasurive që kanë në pronësi.

Lutemi mirëkuptimin tuaj për kryerjen e veprimeve të mësipërme, në mënyrë që të realizojmë një proces të drejtë dhe ligjor shpronësimi.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 23 734 932 (njëzet e tre milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

QARKU: Durrës
FSHATI: BUSHNESH

Nr.	Pronari	ZK	Nr pas.	Arë			Truall			Vlera Totale lekë	Shënime
				Sip.m²	Çmimi m²	Vlera në lekë	Sip. m²	Çmimi m²	Vlera në lekë		
1	Anton Gjergji	1332	72/17	229	327	74883				74883	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
2	Anton Gjergji	1332	72/17	60	327	19620				19620	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
3	Kastriot Rroli	1332	72/21				349	2100	732900	732900	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
4	Beram Stafa	1332	72/14	260	327	85020				85020	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
5	Beram Stafa	1332	72/14	47	327	15369				15369	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
6	Hamza Marku	1332	72/15	284	327	92868				92868	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
7	Hamza Marku	1332	72/15	43	327	14061				14061	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
8	Gjon Masku	1332	72/16	773	327	252771				252771	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
9	Gjon M Lasku	1332	72/16	109	327	35643				35643	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
10	Llesh P Gjergji	1332	72/18	317	327	103659				103659	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
11	Llesh P Gjergji	1332	72/18	37	327	12099				12099	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
12	Vlash P Gjergji	1332	72/12	493	327	161211				161211	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
13	Vlash P Gjergji	1332	72/12	51	327	16677				16677	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi

14	B/P “Marku”	1332	72/11	201	327	65727				65727	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
15	B/P “Marku”	1332	72/11	21	327	6867				6867	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
16	Lek Kola	1332	72/5	311	327	101697				101697	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
17	Gjergj Kola	1332	72/6	1184	327	387168				387168	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
18	Hasan Myrta	1332	70/3	682	327	223014				223014	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
	TOTALI			5102		1668354	349		732900	2401254	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS “THUMANË-MILOT”

QARKU: Durrës
FSHATI: THUMANË

Nr.	Pronari	ZK	Nr pas.	Arë			Truall			Vlera Totale lekë	Shënime
				Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		
1	Bashk.pronësi.”Rryci”	3599	32/2/2	157	442	69394				69394	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
2	Mentor&Blerim Rryçi	3599	32/28				2215	2100	4651500	4651500	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
3	Sherife Rryci	3599	32/3/2	209	442	92378				92378	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
4	Nevruz Rryci	3599	32/14	282	442	124644				124644	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
5	Asllan Rryci	3599	29/2	101	442	44642				44642	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
6	Mentor&Blerim Rryçi	3599	32/16	1541	442	681122				681122	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
7	Mentor&Blerim Rryçi	3599	32/31	46	442	20332				20332	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
8	Bashk.pronësi.”Rryci”	3599	28/6/1	428	442	189176				189176	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
9	Zan Seli Muzhaqi	3599	28/8/1	394	442	174148				174148	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
10	Hajdar Seli Muzhaqi	3599	28/7/1	987	442	436254	92	2100	193200	629454	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
11	Bajram Dani	3599	28/11	969	442	428298				428298	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
12	Bajram Dani	3599	28/12	430	442	190060				190060	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
13	Kasem Dani	3599	22/2	1470	442	649740				649740	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi

14	Hysen Sula	3599	22/25	510	442	225420				225420	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
15	Muharrem Shima	3599	22/26	274	442	121108				121108	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
16	Ali Shima	3599	22/8/1	444	442	196248				196248	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
17	Gëzim Shima	3599	22/9/1	359	442	158678				158678	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
18	Imer Shima	3599	22/10/1	317	442	140114				140114	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
19	Zenel Gabili	3599	35/1/2	1323	442	584766				584766	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
20	Islam Rryçi	3599	2	551	442	243542				243542	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
21	Nezir Jangozi	3599	10	1222	442	540124				540124	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
22	Nel Jangozi	3599	11	806	442	356252				356252	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
23	Nel Jangozi	3599	6	2739	442	1210638	200	2100	420000	1630638	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
24	Osman Dika	3599	1	1564	442	691288	200	2100	420000	1111288	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
25	Zenel Dika	3599	3	377	442	166634				166634	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
26	Veli Keqi	3599	4	674	442	297908	200	2100	420000	717908	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
27	Vesel Keqi	3599	5	10	442	4420	200	2100	420000	424420	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
28	Vesel Keqi	3599	6	159	442	70278	200	2100	420000	490278	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
29	Fejzulla Caka	3599	7				33	2100	69300	69300	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
30	Hamid Jangozi	3599	9	352	442	155584	79	2100	165900	321484	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
31	Vesel Jangozi	3599	8	319	442	140998	108	2100	226800	367798	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
32	Zenel Dika	3599	10	952	442	420784				420784	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
33	Beram Keqi	3599	66/18	252	442	111384				111384	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi

34	Vesel Keqi	3599	6610	915	442	404430				404430	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
35	Xhemal Jangozi	3599	89/17	1071	442	473382				473382	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
36	Idriz Jangozi	3599	89/18	883	442	390286				390286	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
37	Hasan Mana	3599	89/19	893	442	394706				394706	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
38	Muharrem Mana	3599	89/20	385	442	170170				170170	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
39	Xhemal Mirdita	3599	89/22	928	442	410176				410176	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
40	Dave Aliu	3599	26	1531	442	676702				676702	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
41	Hasan Aliu	3599	25	1878	442	830076				830076	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
42	Xhemal Aliu	3599	24	933	442	412386				412386	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
43	Adem Fresku	3599	23	1101	442	486642				486642	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
44	Hajrie Fresku	3599	21	773	442	341666				341666	Proces rikonfirmimi, saktësimi dhe riverifikimi
	TOTALI			31509		13926978	3527		7406700	21333678	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 25.11.2009
Doli nga shtypi më 26.11.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë